

AKT THEMELIMI

I SHOQERIS ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME ORTAKERI

" K O Z M O S "



Ne mbeshtetje te Ligjit 7638 dt.19.11.1992 dhe Ligjit 7667 dt. 28.01.1993, sot me date 15.04.1996 ne ortaket Thanas Kozma Rubije, i dat.1966 lindur dhe banues ne Sarande dhe Janis Spiro Lomi i dat.1963, lindur ne Delvine e banues ne Igumenic Greqi me deshiren dhe vullnetin tone te perba shket formulojme kete akt themelimi te shoqeris me pergjegjesi te kufizuar me ortakeri " KOZMOS" ( SH.P.K.) :

NEFI 1

Te krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me ortakeri "KOZMOS" e ortakeve themelues Thanas Rubije e Janis Lomi. Shoqerija i nenshtrohet legjislacionit shqiptar dhe do te zhvilloje veprimtarine e saja ne baze te ketij akti themelues e statutit qe do te miratohen nga ortaket. Kjo shoqeri do te ushtroje veprimtari brenda dhe jashte vendit.

NEFI 2

Shoqerija do te kete seline e saja ne lagjen "Limjon" te qytetit te Sarandes. Shoqerija mund te hape dege te saja me vendqendrimte te dyta, operative, filiale, perfaqsi e agjensi ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte shtetit duke zbatuar legjislacionin perkates.

NEFI 3

Shoqerija do te kete nje veprimtari ekonomike te saj pa nderprerje mbi 10 vjet.

NEFI 4

Shoqerija me krijimin e saj ka nje kapital themeltar 100.000 lek dhe perbehet nga 50% nga sejcili ortak.

NEFI 5

Shoqerija do te kete si objekt te veprimtarise se saja :

- Te ushtroje veprimtari ekonomike private ne fushen e ndertimeve detare, ndertime protuale, basene, punime thellesie ne prote, vepra te vecanta e punime speciale, cpime e puse hidro gjeollogjike, cpime e puse gjeollogo inxhinjrike, cpime puse uji, mirembajtje e punime sherbime te zakonshme te sistemit komunal, tregtimin me shumic e pakic import eksport te cdo lloj

material ndertimi, pjese kembimi per makineri te cdo lloji, artikuj idustria

NEFI 6

Shoqerija mund te ndryshoje emerin, selin, kapitalin, objektin e veprimta rise duke ndjekur per kete rugen ligjore te miratimit. Shoqerija do te bashkepunoje me persona fizik e juridike brenda e jashte vendit.

NEFI 7

Me miratimin e ortakëve themelues mund te pranohen shtetë ortakë ne shoqeri edhe persona te tjere. Ne baze te kontratës se punes ne shoqeri mund te punesohen punonjes e specialiste te ndryshem.

NEFI 8

Ortakët kane detyrime te njejta per zbatimin e ligjeve. Ata duhet te bejne perpjekje per ritjen e potencialit ekonomik te shoqeris.

NEFI 9

Shoqerija do te drejtohet nga ~~nga~~ administratorët me vendime unanime. Administrator do te jete z. Thanas Rubije

NEFI 10

Veprimtaria ekonomike financiare e shoqeris do te mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti.

NEFI 11

Te ardhurat neto qe do te realizohen do te ndahen midis ortakëve sipas marreveshjes se tyre.

NEFI 12

Ky akt themelimi eshte i detyrueshem per ortakët dhe te punesuarit ne shoqeri. Ndryshimi i legjislacionit do te sjelle ndryshime ne aktin e themelimit dhe statut duke ju pershtatur kerkesave te ligjit.

NEFI 13

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate zbatimit te ketij akti themelimi kur nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te zgjidhen nga Gjykata e rrethit. Shoqerija ne zgjidhejen e problemeve juridike dhe ne Gjykate do te perfaqsohet nga Av. Shpetim Hima.

NEFI 14

Statuti i shoqeris eshte pjese perberese e ketij akti themelimi.

NEFI 15

Shoqerija perfaqsohet nga administratori i saj z. Thanas Rubije dhe





ne marrëveshje të tij nga ortakut z. Janis Lomi.

NUMRI 16

Ky akt themelimi përpilohet në kate origjinale për tju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbahet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

O R T A K E T

Thanas Rubije

Janis Lomi

REPUBLIKA SHQIPERISE


Nr. 10018 Rep.

NOTERIA TIRANE

V E R T E T I M

Në Tiranë sot me datë 3.05.1996 (nëntëdhjetë e gjashtë) u paraqitën Thanas Kozma Rubije dhe Janis Spiro Lomi banues në Sarandë, madhore, me zotësi të plote juridike për të vepruar, për identitetin e të cileve u sigurova në dokumentat përkatëse, të cilët me vullnetin e tyre të lire dhe të plote me deklaruan përmbajtjen e këtij akti themelimi duke e nënshkruar para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjes.

N O T E R I



S T A T U T I

I SHOQERIS ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME ORTAKERI

" K O Z M O S "

Ne mbeshtetje te Ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe Ligjit 7667 date 28.01.1993, sot me date 15.04.1996 ne ortaket Thanas Rubije dhe Janis Loni formulojne kete statut te shoqeris me pergjegjesi te kufizuar me ortakeri "KOZMOS" ( SH.P.K.) :

FORMIMI

NENI 1

Shoqerija qe krijohet eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me ortakeri qe emertohet "KOZMOS" SH.P.K.

SELIJA E SHOQERIS

NENI 2

SH.P.K." KOZMOS " do te kete seline e saje ne lagjen "Limjon" te qytetit te Sarandes. Shoqerija mund te hape dege te saje me vendqendrimet e dyta operative, filiale, perfaqsi dhe agjensi ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperis dhe ne shtete te tjera duke zbatuar legjislacionin tyre perkates.

KOHE ZGJATJA

NENI 3

Shoqerija do te kete nje veprimtari ekonomike pa nderprerje mbi 10 vjet.

KAPITALI THEMELTAR

NENI 4

Shoqerija me krijimin e saj ka nje kapital themeltar 100.000 lek te perbere nga 50% nga sejcili ortak.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 5

Shoqerija ka si objekt te veprimtarise se saje :

- Te ushtroje veprimtari ekonomike private ne fushen e ndertimit detare; ndertime portuale, basene, punime thellesie ne porte, vepra te vecanta e punime speciale, cpime e puse hidro gjeologjike, cpime e puse gjeologjike inzhinjerike, cpime puse uji, mirembajtje e punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal tregtimin ne shumic e pakic import eksport te cdo lloj



materia ndertimi, pjese kembimi per makineri te cdo lloji, artikuj industri

ORGANET DREJTUESE

NENI 6

Organet drejtuese te SH.P.K. "KOZMOS" jane :

1. Asambleja
2. Administratoret
3. Komisioni i Revizionit



Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese , emerimi dhe shkaktimi i anetareve dhe ceshtje te tjera te rendesishme per funksionimin e tyre rregullohen sipas ketij statuti.

NENI 7

Asambleja perbehet nga ortaket themelues te saj. Asambleja e shoqeris eshte organ sovran.

Vendimet qe mer Asambleja bazuar ne kete statut dhe ligjeve ne fuqi jane te detyrueshme per tu zbatuar nga te gjitha ortaket dhe te punesuarit. Vendimet formulohen dhe nenshkruhen nga administratori.

Asambleja thihet sa here ta shikojne te nevojshme ortaket, por detyrimisht ne Dhjetor per te miratuar programin e veprimtaris se shoqeris per vitin e ardheshem dhe ne Mars per te miratuar bilancin e vitit te meparshem.

Vendimet jane te vlefshme kur jane marre ne miratim unanim te ortakeve.

NENI 8

Asambleja drejtohet nga administratori. Administrator i SH.P.K. "KOZMOS" eshte z. Thanas Rubije.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 9

Shoqerija deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban akti i themelimit, statuti dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi. Shoqeria fiton zotesin per te vepruar me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar ne Gjykaten e rrethit Tirane dhe ushtron aktivitetin ekonomik me marjen e lejes nga organi tatimor. Shoqerija do te kete vullen e saj.

NENI 10

Shoqerija mer vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe ketij statuti te cilat jane te detyruara per zbatim nga te punesuarit ne shoqeri. Shoqer



pergjilajet vete per drejtimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore kapitalit te saja.

NEUNI 11

Asambleja sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare emerom specialsite te fushave te ndryshme dhe punesor punonjes. Shoqerija per te punesuarit lidh kontrata pune sipas legjislacionit ne fuqi.

NEUNI 12

Administratori eshte i veshur me te gjitha fuqit per drejtimin e zakonshem dhe te jashte zakonshem te shoqeris. Shoqerija ka te drejte te lidhe kontrata me shoqeri te tjera brenda dhe jashte vendit, te kryej veprime depozitimi; kreditimi, pague, arketuase etj.

MARRREDHENJET E PUNES

NEUNI 13

Marredhenjet e punes ne shoqeri rregullohen nepernjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontrate do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi per punesimin.

Mosmarreveshjet midis te punesuarve dhe shoqeris kur nuk do te jet e mundur te zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen nga Gjykata e rrethit.

Punonjesit e emruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimeve qe realizo shoqerija. Per punene e kryer punonjesit marrin pagen sipas kontrates se punes.

NEUNI 14

Shoqerija perfaqsohet nga administratori i saj dhe ne mungese te tij nga ortaku tjeter Janis Lomi. Per zgjidhjen e problemeve juridike dhe ne Gjykate shoqerija do te perfaqsohet nga Av. Shpetim Hima. Kete te drejte perfaqsimi Av. Shpetim Hima do ta kete edhe ne organet e tjera shteterore.

NEUNI 15

Ortaket kane te drejte dhe te marrin pjese dhe te kerkojne te dhen mbri administrimin e veprimtarise ekonomike te shoqeris.

Cdo ortak ka te drejte te terhiget nga shoqerija duke paraqitur dy muaj me pare kerkesen me shkrim. Heqja dore nuk e liron ortakun nga obligimet e marra dhe nuk pezullon detyrimet e shoqeris ndaj ortakut.

NEUNI 16

Te drejten e nenshkrimit ne emer te SH.P.K "KOZMOS" e kane ortaket

themelues dhe personat e tjere me autorizim te posacem nga administratori i kompanise.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NEFI 17

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqeris do te mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ncurretbilanci kontabel me rezultatin ekonomik me fitim humbje, bazuar ne regullat e nejerjes se kontabilitetit nga njesit ekonomike private.

Me miratimin e bilancit kontabel Asambleja vendos per krijimin e fondeve te ndryshme si fondi akumulimit, fondi rezerve etj.

NEFI 18

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, ndahen midis ortakeve sipas marreveshjes se tyre.

SHPERBERJA E SHOQERIS

NEFI 19

Shperberja e shoqeris mund te vije ne cdo kohe dhe per cdo shkak si humbje e kapitalit te shoqeris, heqje e te drejtes per te ushtruar profesionin tregtar si dhe ne te gjitha rastet e tjera te percaktuara ne ligje. Ne keto raste Asambleja vendos per menyren e likuidimit. Ne se fonde nuk rezultojne te mjaftueshme per shlyerjen e detyrimeve, ato likuidohen teresisht dhe me pasurite e tyre.

DISPOZITA TE BERGJITHESME

NEFI 20

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet dispozitave ligjore ne fuqi.

NEFI 21

Statuti perpilohet ne kater origjinale per tju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje mbahet ne dokumentat baze te shoqeris.

O R T A K E T

Thanas Kozma Rubije Janis Lomi

*(Handwritten signatures)*

Nr. 10.018 Rep

REPUBLIKA SHQIPERIS  
NOTERIA TIRANE

V E R E T I M

Ne Tirane sot me date 3.05.1996 (nentedhjet e gjashte) u paraqit Thanas Kozma Rubije dhe Janis Spiro Lomi banues ne Sarande, madhore, ne zot te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova ne dokumentat perkatese, te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote de